

VENDIM
Nr. 788, datë 7.10.2020

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, TË OBJEKTIT ME SIPËRFAQE 644
M², PJESË E PASURISË ME NUMËR 11/86, NË ZONËN KADASTRALE 8320,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të objektit me sipërfaqe 644 m², pjesë e pasurisë me numër 11/86, në zonën kadastrale 8320, Tiranë, sipas planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, të përdorur për kryerjen e aktivitetit të Qendrës së Monitorimit të Trafikut Rrugor.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLAN RILEVIMI

Ne Pronesi te: DREJTORIA E RAJONIT QENDROR, TIRANE (AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR)

SH 1:750

SISTEMI KOORDINATIV - UTM Zone 34N



LEGJENDA			
Nr	Objekti	Sip. e objektit ne m2	Sip. e truallit nen objekti ne m2
1	A	302.4	240
2	B	644	
3	C	214.4	
4	D	333	
5	E	401	
6	F	632.6	
7	G	678	
8	H	175	
	Sip.Totale	3380.4	

Sip.truall:6587 m2
Sip.tot.ndertimi:3380.4 m2



Punoi:
"GJECONCONSULT & CO" shpk
Liç. N.6408/15

janar 2019